



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL¹

(I përmbledhur)

Tiranë, më 21.03.2019, ora 14.00

Drejton mbledhjen -

Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës :

1. Diskutimi dhe miratimi i Projektvendimit për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Marrin pjesë² :

- | | |
|--------------------------|------------------------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Vitore Tusha | (zëvendës kryetare) |
| 3. Arta Marku | (anëtare) |
| 4. Fatri Islamaj | (anëtar) |
| 5. Margarita Buhali | (anëtare) |
| 6. Eriol Roshi | (anëtar) |
| 7. Medi Bici | (anëtar zëvendësues) |
| 8. Klodiana Veizi (Mema) | (anëtare zëvendësuese) |

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike qëndrimet dhe diskutimet e plota të vetë anëtarëve të KED, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

² Anëtarja e Fatjona Memçaj nuk merr pjesë në diskutimin dhe miratimin e akteve nënligjore normative, për shkak të papajtueshmërisë- marrëdhënie krushtëje e afërt me kandidaten Ardita Alsula. Sipas ligjit, Kryetari i Këshillit e ka miratuar heqjen dorë me vendimin nr.1 datë 14.02.2019.

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :

1. Vilma Shurdha, përfaqësuese e Avokatit të Popullit

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016 :

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare, mbështetëse të procesit të hartimit të akteve nënligjore të KED :

1. Grzegorz Borkovski, ekspert i EURALIUS

2. Julinda Beqiraj, ekspert i EURALIUS

3. Maniela Sota, Koço Bendo, përkthyes për EURALIUS

HAPET MBLEDHJA

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Në mbledhje nuk merr pjesë anëtari zëvendësues i Këshillit, zoti Gurali Brahimllari, i cili, sipas njoftimit e ka të pamundur pjesëmarrjen për shkak të delegimit dhe pjesëmarrjes në gjykime të rëndësishme jashtë qytetit të Tiranës.

Ardian Dvorani lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

Diskutimi dhe miratimi i Projektvendimit për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit miratojnë rendin e ditës së programuar.

Këshilli vijon mbledhjen sipas rendit të ditës me *Diskutimin dhe miratimin e Projektvendimit për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*

Ardian Dvorani, si relator i projektaktit, bën një parashtrim hyrës për diskutimin mbi projektaktin që përmban parimet e përgjithshme dhe rregullat mbi kriteret e vlerësimit dhe të pikëzimit, si edhe mbi përmbajtjen e projektanekseve të vlerësimit dhe pikëzimit, në të cilat janë reflektuar vërejtje dhe sugjerime nga mbledhja e kaluar e Këshillit, në veçanti për procedurat që ndiqen për kryerjen e vlerësimit, përcaktimin dhe respektimin e afateve të vlerësimit, nevojën e

rregullimit të fazës përgatitore të këtij procesi, problematikën në parim dhe në situatën aktuale të kryerjes së procesit për shumë vende vakante njëkohësisht dhe përcaktimeve të ligjit për harimitn e dy listave të veçanta me gjyqtarë dhe jogjyqtarë, për miratimin ose jo të rregullit të sugjerimit të përshtatshmërisë së kandidaturës sipas kriterit të arritjes së 60% të pikëve për kriter, për mënyrën e përcaktimit të pikëve nga mbledhja e Këshillit për secilin kriter dhe kandidat, me votim apo si shumatore e vlerësimit të secilit anëtar pjesëtuar me numrin e tyre etj.

Anëtarët e Këshillit vendosin të vijojnë diskutimin duke filluar me dispozitat e projektaktit për kriteret dhe procedurat evlerësimit dhe pikëzimit, dhe trajtuar njëkohësisht edhe çështjet parimore lidhur me to.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e titullit dhe pjesës së mbështetjes e të delegimit ligjor për nxjerrjen dhe miratimin e projekt aktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë me disa vëretje dhe sugjerime përmbajtjen e pikave të Kreut I “Dispozita të Përgjithshme”.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë përmbajtjen e dispozitave të Kreut II “Kriteret e vlerësimit të kandidatëve, pesha specifike dhe pikëzimi i tyre”

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë me disa vëretje dhe sugjerime përmbajtjen e pikës 3 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë me disa vëretje dhe sugjerime përmbajtjen e pikës 4 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 5 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë me disa vëretje dhe sugjerime përmbajtjen e pikës 6 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 7 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe diskutojnë përmbajtjen e pikës 8 të projektaktit.

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe sugjeron se ligji i posaçëm i zbatueshëm për vlerësimin e kandidatëve është ligji nr. 8577/2000 për kandidatët për Gjykatën Kushtetuese dhe nenet 199 dhe 201 për kandidatët Për Inspektor i Lartë i Drejtësisë dhe këto të citohen shprehimisht në këtë pikë të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit kalojnë me disa vëretje dhe sugjerime përmbajtjen e pikës 8 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 9 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 10 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 11 të projektaktit, si edhe shtimin e një pike tjetër pas saj për miratimin e metodologjisë në vlerësimin dhe caktimin e pikëve lidhur me secilin nga kriteret e detajuar në Shtojcat 1 dhe 2 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë përmbajtjen e dispozitave të Kreut III “Rregulla të përgjithshme të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve”, duke filluar me Seksionin A “Përgatitja dhe zhvillimi i procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve”.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 12 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 13 të projektaktit, si edhe diskutojnë në parim për lidhjen e këtij rregulli edhe me problematikën e ndjekjes dhe respektimit të procedurave për shkak të njëkohshmërisë për shqyrtim aktualisht të shumë vendeve vakante edhe nga i njëjti organ emërtese, për çështjen e dy listave me gjyqtarë e jogjyqtarë etj..

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 14 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë përmbajtjen e dispozitave të Seksionin B “Të drejtat e kandidatit”.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 15 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 16 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë përmbajtjen e pikës 17 të projektaktit dhe diskutojnë veçanërisht nëse kjo dispozitë është e dobishme për procesin dhe aq më tepër brenda delegimit ligjor për KED kur propozohet të parashikojë të drejtën e kandidatit që të shprehet para Këshillit për vendin vakant ku ai preferon të përzgjidhet mes vakancave ku ka kandiduar njëherësh.

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe sugjeron se kandidatët për vendet vakante kanë edhe të drejtën të tërhiqen fare nga kandidimi. Kështu që preferencat nëse i shprehin me shkrim, kjo nuk është ndalim. Sa do ta diktoj kjo punën e Këshillit pastaj kjo është tjetër gjë dhe është e lidhur me kapitujt më vonë. Sepse ndërkohë po marrim një rast hipotetik. Nëse i njëjti magjistrat, po them gjyqtar, se edhe kjo është një diskutim që do të dalë më mbrapa, ka aplikuar tek Presidenti për vakanën nr.1 me mandat 9 vjeçar dhe nuk ka aplikuar për atë nr.2 me mandat 4 vjeçar. Nëse vijnë dy lista nga KED dhe ne e zgjedhim tek vakanca nr.2, a do të konsiderohet kjo e rregullt. Për shkak se kandidati do të thotë unë nuk kam aplikuar për tek vakanca nr.2. Pra a e zgjidh preferenca këtë problem? Si organ emërtese, ne nuk na pengon asnjë gjë dhe do të zgjedhim në fund të ditës ata që do të vijnë të renditur nga ju. Unë mendoj më mirë kalojeni për më vonë vendimin për këtë dispozitë, pasi të mblidhen e të zgjidhen të gjitha çështjet pikante sesa ta lëmë një hapësirë këtu.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 18 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë përmbajtjen e dispozitave të Seksionin C “Afatet dhe llogaritja e tyre”.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 19 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 20 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 21 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 22 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 23 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë përmbajtjen e dispozitave të Seksionin Ç “Njoftimet”.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 24 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 25 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 26 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë përmbajtjen e dispozitave të Kreut IV “Veprimet përgatitore për realizimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve”.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 27 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 28 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 29 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 30 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë me disa sugjerime përmbajtjen e pikës 31 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe diskutojnë përmbajtjen e pikës 32 të projektaktit.

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe lidhur me listën e dokumenteve që kandidati dorëzon për procesin e vlerësimit të kandidaturës sugjeron se përcaktimi i numrit 5 të dokumenteve profesionale që dorëzohen duhet formuluar pak ndryshe jo si një kusht, si një detyrim për pikëzimin e kandidaturës por si një rekomandim orientues. Mund të përcaktohet edhe si orientim për të sjellë p.sh. minimalisht 3 deri në 5 dokumente profesionale. Vërtet një kandidat ndoshta nuk meriton të jetë gjyqtar kushtetues kur nuk sjell për vlerësim 5 dokumente profesionale, por të mos parashikohet si kusht detyrues. Në nenin 240 shkronja “b” përcaktohet një afat, për vlerësimin e punimeve, studimeve, ligjëratave etj. gjatë 5 viteve të fundit. Mund të kërkohe mendim nga Euralius nëse do të përfshihen në vlerësim edhe ato përtej 5 viteve të fundit.

Grzegorz Borkovski (*përkthen përkthyesja*) kërkon fjalën dhe lidhur me listën e dokumenteve që kandidati dorëzon për procesin e vlerësimit të kandidaturës parashtron se vlerëson të japë një shpjegim përse ideja jonë është që të vendosim një numër dhe pavarësisht nëse ky numër është 3 apo 5, ideja është që mund të jemi përpara një situate të tillë ku dikush mund të paraqesë tre monografi dhe sigurisht që relatori do të bëjë vlerësimin e kandidatit duke patur parasysh këtë punë të tij. Një kandidat tjetër mund të sjellë 25 libra. Atëherë çfarë do të thotë kjo që relatori do të lexojë 25 libra dhe pastaj do të mund të bëjë vlerësimin për këtë kandidat? Prandaj është shumë e rëndësishme që të vendoset një numër dhe të vendoset një numër maksimal i nevojshëm sepse ndryshe nuk do të kemi kohë për të bërë vlerësimin e materialeve që do të na

paraqiten. Jemi plotësisht dakord me sugjerimin e bërë për numrin 5 të dokumenteve që të paktën të paraqiten nga kandidati, materiale ose publikime akademike ose dokumente profesionale. Për shkak se nëse vjen një kandidat dhe të paktën nuk ka bërë 5 punë dhe është kandidat për Gjykatën Kushtetuese do të thotë se ky kandidat nuk është i mirë. Gjithashtu mundësia tjetër mund të jetë që ky kandidat mund të sjellë edhe 100 punë të tija që ka bërë. Por, ndërkohë, të jetë vetë ai që të cilësojë 3 deri në 5 punë të tija për tu marrë në konsideratë në vlerësim sepse ai vetë mendon që këto 3 deri në 5 dokumente janë materialet, punimet e tij më të mira.

Anëtarët e Këshillit kalojnë me disa sugjerime përmbajtjen e pikës 32 të projektaktit, duke mbajtur parasysh diskutimet mbi listat e dokumenteve për vlerësim në diskutimin dhe miratimin e Shtojcave të projektvendimit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 33 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 34 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 35 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe diskutojnë përmbajtjen e pikës 36 të projektaktit lidhur me veprimet e relatorit pas kryerjes së veprimeve përgatitore, për shqyrtimin dhe përgatitjen prej tij të dokumentacionit të secilit kandidat për vlerësim dhe pikëzim, përgatitjen e relacionit dhe të elementëve që ai përmban mbi procedurat e ndjekura, dokumentet e paraqitur, përmbledhjen e përmbajtjes së këtyre dokumenteve.

Vilma Shurdha kërkon fjalën dhe parashtron se në lidhje me këtë pikë vërejmë se i vetmi relacion që do merret nga Avoakti i Popullit do të jetë vetëm ky mbi veprimet përgatitor. Ndërsa konkluzionet e vlerësimit që mund të bëjë relatori nuk do të vihen në dispozicion. Nëse e lexojmë në lidhje me pikën 45 më pas, kuptojmë që Avokati i Popullit nuk do të legjitimohet më të jetë pjesë e bisedimeve e vendimmarrjes, të paktën i pranishëm se diskutimi është tjetër gjë. Pra, në pikën 45 më poshtë mbahet ky qëndrim megjithëse ne vazhdojmë të kemi qasjen tjetër. Ky shqetësim është në vazhden e një shqetësimi dhe një qëndrimi që me sa duket është e njëjtë si vendimin nr 4 të KED. Kështu që në këtë kuadër, në emër të Avokatit të Popullit, edhe një herë tjetër rikonfirmojmë qëndrimin tonë në lidhje me prezencën tonë të pakufizuar edhe në fazën e bisedimit dhe votimit të çështjes.

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe parashtron se këtë çështje të Avokatit të Popullit kishim menduar ta ngrinim që në fillim të çështjet parimore. U lanë të mblidhen të gjitha çështjet edhe kur të vijmë tek kapitulli 5, ku përfshihet trajtimi dhe i Avokatit të Popullit. Por meqenëse u hap nga përfaqësuesi i Avokatit të Popullit duhet të rishpreh edhe një herë se është momenti i tretë ku roli i Avokatit të Popullit vihet në diskutim në këtë tryeze. Momenti i parë ishte kur u hartuan dhe miratuan rregullat e funksionimit të brendshëm, ku edhe në prezencë të EURALIUS-it, në mos

gabofsha dhe në kujtesën time, edhe ata nuk patën kundërshtime që aksesin të ishte i plotë. Momenti i dytë ishte data 11.03. kur u miratuan rregullat e tjera për verifikimin e kandidaturave, ku u ndryshua ky qëndrim dhe roli i Avokatit të Popullit sa i takon dhomës së diskutimit mori një largësi për të mos qenë prezent. Duket që në të dy këto mbledhje i vetmi ndryshim është që votimi nga KED ose shumica e votave ndryshon. Në votimin e parë keni një votim 4 me 3 në mos gabofsha dhe në votimin e dytë keni 3 me 3, me rregullin e organit kolegjal vendos vota e kryetarit. Edhe EURALIUS-i ka qenë sërish prezent në mbledhjen e dytë dhe duket sikur ka dhënë pëlqimin që të mos jetë prezent Avokati i Popullit. Mos është momenti i tretë ndoshta dhe i vërtetë që të vijë në diskutim të këtij Këshilli për tu rifutur edhe njëherë si nocion pozicioni i rolit të Avokatit të Popullit. Por me një ndryshim që, në këtë mbledhje, ky është një sygjërim dhe ju kërkohet ndjesë, ndoshta sepse nuk ka të bëjë me një konflikt interesi të zonjës Memçaj tek kjo pikë dhe që ajo duhet të jetë prezente me votimin e kësaj për çështje kaq të rëndësishme për sa i takon transparencës. Unë mendoj kështu si përfaqësues i institucionit të Presidentit sepse po rikthehet me kërkesë të Avokatit të Popullit për të disatën herë, duke treguar që ka një shqetësim, shqetësim të cilin edhe ne e mbështesim si institucion. Kështu që unë këtë çështje do ti sugjeroja Këshillit ta ridiskutonte më vehte në prezencë të 7 anëtarëve dhe të merrte një drejtim përfundimtar.

Vilma Shurdha kërkon fjalën dhe parashtron se në vendimin nr. 4 keni përcaktuar që Avokatit të Popullit i dërgohet edhe dokumentacioni i përgatitur edhe nga relatori mbi veprimet e kryera prej tij gjatë procedurës së ndjekur për verifikimin e kandidatit. Pastaj pas diskutimit të anëtarëve të Këshillit, përsëri Avokati i Popullit mund të parashtrorë mendime dhe vlerësime vetëm lidhur vetëm për mënyrën dhe procedurën. Edhe sot jemi në të njëjtën linjë. Ne kemi kërkuar dhe në mënyrë shkresore të marrim aktet dhe të shohim draftet përfundimtare sepse shohim që ka një paqartësi që na vjen nga momenti i diskutimit këtu dhe deri në momentin e zbardhjes. Prandaj do të doja që të merret në konsideratë dhe kërkesa jonë dhe të mos procedoni me vendimmarrjen në lidhje me pozicionin përfundimtar, brenda mundësive, të Avokatit të Popullit, derisa ne të jemi të qartë se deri në ç'pikë Avokati i Popullit është i legjitimuar të jetë pjesë e procesit. Në terma konkret se çfarë ka ndryshuar nuk mund ta themi deri në momentin që të marrim aktet dhe procesverbalet e regjistrimet audio që kemi kërkuar. Ka një paqartësi në zbardhje të vendimit. Nuk kam qenë pjesë e procesit dhe e mbledhjes parardhese prandaj nuk flas dot në këtë pikë.

Grzegorz Borkovski (*përkthen përkthyesja*) kërkon fjalën dhe parashtron se meqenëse u përmend EURALIUS, në mbledhjen e parë unë nuk kam qenë prezent personalisht, por ka qenë kolegu im Klodian Rado dhe nuk i është e kërkuar të mbajë ndonjë pozicion dhe ai nuk u shpreh. Në mbledhjen e dytë ishte drejtuesja e ekipit në mbledhje dhe ajo u shpreh shumë qartë se

EURALIUS nuk do ishte kundër këtij vendimi. Pse kemi këtë mendim? Kjo është një procedurë që përngjason dhe është njëta siç zhvillohet në seancë gjyqësore. Kjo do të thotë që gjithkush mund të jetë i pranishëm në sallën e gjyqit. Gjithkush mund të degjojë dëshmitarët e kështu me radhë. Por kur mbaron seanca, në marrjen e vendimit e pranishme është vetëm gjykata. Nuk ka asnjë prokuror të pranishëm, as Ombudsman, as avokat. Për këtë shkak EURALIUS e ka mendimin të prerë dhe këtë do mbajë dhe në të ardhmen që Ombudsman që nuk duhet të jetë i pranishëm gjatë bisedimeve në dhomë me dyer të mbyllura .

Anëtarët e Këshillit e kalojnë përmbajtjen e pikës 36 të projektaktit me përmbajtjen e propozuar.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 37 të projektaktit, duke vendosur të shtojnë një pikë tjetër më përpara (të numërtuar 37) për të parashikuar që në rast të ndalimit të kandidimit veprimet përgatitore për procedurën e vlerësimit ndërpriten. Pika ekszistuese 37 bëhet 38.

Këshilli ndërpret diskutimet për një pushim të shkurtër.

PJESA E DYTË E MBLEDHJES

Anëtarët e Këshillit, pas pushimit, vijojnë me shqyrtimin dhe diskutimet rreth Kreut V “Fillimi dhe zhvillimi i procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve”. Fillimisht me Seksionin A “Thirrja e mbledhjes për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve”.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 38 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 39 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 40 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 41 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit, vijojnë me shqyrtimin dhe diskutimet për Seksionin B “Seanca e parë e mbledhjes për procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve”.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 42 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 43 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 44 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe diskutojnë mes tyre për përmbajtjen e pikës 45 të projektaktit lidhur me mënyrën e bisedimit dhe votimit të çështjeve që propozohet të bëhen vetëm me praninë e anëtarëve të KED.

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe parashtron se paraprakisht ndoshta duhet sqaruar në pikën 43 nëse për gjuhët e huaja do të vlerësohet vetem anglishtja apo dhe frëngjishtja. Ndërsa tek pika 44 mos do ishte vendi, nëse ju e vlerësoni me vendimmarjen tuaj që, përveç mendimit të Avokatit të Popullit, edhe subjektet ftuar mund të japin ndonjë opinion proceduralisht për ndonjë çështje. Për të hyrë pastaj tek pika 45 e cila duket sikur po rihapet prapë. Kur e diskutuam vendimin nr. 4 mbaj mend që u përdor një shprehje se rregullat nuk janë strikte, ndryshojnë. Meqenëse do i qëndrojmë të njejtës linjë dua të them që sinqerisht edhe njëherë për këtë pjesë mendoj që Këshilli duhet ta diskutojë në prezencën e të 7 anëtareve sepse nuk kanë lidhje me asnjë pozitë të konfliktit të interesit të znj Memçaj. Jam për pjesëmarrjen e Avokatit të Popullit. Mua më vjen mirë, sinqerisht që Euralius ka një pozicion të qartë se është kundër. Në mbledhjen kur ishte znj. Agnes, kryetarja e këtij misioni, nuk ka pas ide të qartë dhe shqyr që u qartësua në këtë mbledhje që EURALIUS del kundër pjesëmarrjes së Avokatit të Popullit në të gjithë veprimtarinë e Këshillit. Unë do ta ftoj Këshillin ta dikutonin edhe njëherë në këtë prizëm, duke ruajtur që kuorumin e vendimarrjes mbi këtë çështje që të ishte i njëjtë. Të votojnë të 7 anëtarët nëse ky pozicion i avokatit do të jetë siç ishte si në rregulloren e parë apo siç është përcaktuar në vendimin që u miratua në datën 11 mars. Në mbështesin edhe njëherë që Avokati i Popullit e ka të përcaktuar pozicionin në nenin 233, “*merr pjesë në mbledhjen dhe në veprimtarinë e Këshillit*. Ai është zëri i vetëm i transparencës dhe, në mos gaboj, edhe në komentarin që i është bërë ndryshimeve kushtetuese pas ndryshimeve të reformës në drejtësi, ky pozicion mbahet për Avokatin e Popullit, si vetmja transparencë për mbrojtjen e interesit publik. E ftoj Këshillin ta shkojë në këtë prizëm këtë çështje delikate. Nuk dua të komentoj fjalën tuaj (*kryetarit*) por pjesëmarrja e znj. Memçaj nuk ka asnjë lidhje me themelin e kërkesës së saj për të qënë apo për të mos qënë në shqyrtimin e kësaj rregulloreje. Po flasim për pjesëmarrjen ose jo të Avokatit të Popullit në procesin rutinë të punës së Këshillit që është një e drejtë që ia njih ligji dhe qenia e znj. Memçaj për shqyrtimin e këtyre dy pikave duket në dukje sikur nuk shkon por në këto dy aspekte në të vertete është e rëndësishëm pasi Këshilli përfundimisht duhet të mbajë një qëndrim për këtë pikë. Mendoj që e ka këtë të drejtë të jetë prezent gjatë diskutimeve të çështjes nga Këshilli, si në mbledhjen apo veprimtarinë e tij. Vendimarrja është e Këshillit dhe unë nuk i rikthehem më kësaj çështjeje. Këshilli duhet ta kishte menduar më gjatë kur e ndryshoi rregullin sepse teknikisht dhe vendimi i parë që është marrë për organizimin e brendshëm nuk ka ndryshuar. Pra janë dy akte në fuqi. Është ai i pari ku është e prezencën e plotë e Avokatit të Popullit. Është edhe ky i dyti që e ka kufizuar.

Vilma Shurdha kërkon fjalën dhe parashtron se është me rëndësi pjesëmarrja e zonjës Memçaj, pikërisht se tashmë qëndrimi po merr trajtë të konsoliduar. Pozicionin e Avokatit të Popullit e sjellim dhe e risjellim në diskutim pikërisht në funksion të asaj që përcakton ligji. Nuk e

gjejmë të përcaktuar në nenin përkatës të Kushtetutës dhe as në nenin e transparencës pjesmarrjen e pjesshme të Avokatit të Popullit. Ajo është një pjesëmarrje e vazhdueshme dhe jo e fragmentuar. Natyrisht dëgjuam edhe arsyetimin e përfaqësuesit të EURALIUS-it dhe do të sillja ne vëmendje faktin që Ok ju jeni kundër por nuk e di mbi çfarë bazë ligjore dhe nen ju mbështesni prezencën e pjesshme të Avokatit të Popullit. Do të kishim diskutim nëse do të kishte një opinion të Avokatit të Popullit nëse do ishte i pranishëm në dhomë këshillimi apo do të ishte thjesht vëzhgues. Por prezenca në mbledhjet dhe veprimtaritë e Këshillit është një gjë që nuk duhet të vihet në diskutim sepse është një drejtë e cila njihet edhe nga neni 149/d i Kushtetutës dhe nga neni 233 i ligjit nr. 115/2016. Tashmë kjo prezencë e fragmentuar po merr trajtë të konsoliduar nga njëra rregullore në tjetrën dhe nuk e dimë ku mbështetet. Kështu që përsëri do ta ftoja Këshillin ta shikonte Avokatin e Popullit pikërisht në pozicionin që i është dhënë që në krye të herës, nëse i referoheni dhe komentarit. Avokati i Popullit është prezent si një vëzhgues, si një sy për transparencën. Ne jemi thelluar për të gjetur se ku legjitimohemi të jemi prezent dhe ku nuk legjitimohemi të jemi prezent. Nuk e gjejmë në ligj, nuk e gjejmë në rregulloren e parë e cila na ka legjitimuar për të qënë prezent për gjatë gjithë mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit. E shohim për herë të parë të shprehur tek vendimi nr.4 dhe me pas të konsoliduar tek ky projektvendim. Gjithmonë e më shumë Avokatit të Popullit i rikonfigurohet pozicioni edhe njëherë tjetër dhe i jepet nje pozicion i cili është terësisht në kundërshtim me atë që i është dhënë më herët dhe nga Kushtetuta dhe nga ligji.

Grzegorz Borkovski (*përkthen përthyesja*) kërkon fjalën dhe parashtron se jemi dakord për sa i takon diskutimit që po e rihapni vazhdimisht këtë çështje dhe adresimit që i bëhet Këshillit për këtë çështje. Por për mendimin tonë kjo çështje është e mbyllur.

Anëtarët e Këshillit, pasi e diskutojnë edhe një herë çështjen, duke vlerësuar se nuk ka vend për të ndryshuar qëndrimet tashmë të mbajtura të anëtarëve, e kalojnë përmbajtjen e pikës 45 të projektaktit sikurse është propozuar.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 46 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë me disa ndryshime përmbajtjen e pikës 47 të projektaktit. Vendimet do të merren me shumicën e të gjithë anëtarëve të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 48 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit, vijojnë me shqyrtimin dhe diskutimet për Seksionin C “Seancat e mbledhjes për intervistat me kandidatët”.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 49 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 50 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe diskutojnë përmbajtjen e pikës 51 të projektaktit lidhur me mundësinë e verifikimit të njohurive të gjuhës së huaj dhe rolin e ekspertit në këtë procedurë.

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe parashtron se përveç këtyre që ju sapo keni rënë dakord, duhet mbajtur parasysh edhe se si do orientohen ekspertët për të pyetur dhe çfarë do të pyesin. A do të ketë një listë pyetjesh bazë mbi të cilën eksperti mund të diskutojë me kandidatin, pyetje të paracaktuara dhe që tëkenë një lloj standardi apo mund ti pyesin në mënyra të ndryshme? E dyta, kandidatët mund të kenë certifikatë C1, C2 apo TOEFL etj.. Ka plot në Shqipëri dhe dihet mënyra se si dhe mund ti kenë përfituar. Për të krijuar të njëjtin standard, a do të futen të gjithë ata në një intervistë të tillë, me të njëjtën logjikë tuajën si në rastin kur vumë në dyshim edhe raportin e ILDKPI-së, duke krijuar mundësinë të hyjmë në një hetim të thelluar.

Anëtarët e Këshillit kalojnë me disa ndryshime përmbajtjen e pikës 51 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 52 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 53 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 54 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 55 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 56 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 57 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 58 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë me disa ndryshime përmbajtjen e pikës 59 të projektaktit. Për rrjedhojë hiqet edhe pika 60 e projektaktit.

Anëtarët e Këshillit, vijnë me shqyrtimin dhe diskutimet për Seksionin Ç “Bisedimet e Këshillit për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidaturave”.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 61 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 62 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 63 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 64 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë me disa ndryshime përmbajtjen e pikës 65 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe diskutojnë përmbajtjen e pikës 66 të projektaktit, veçanërisht për propozimin e paraqitur nga relatori i këtij projektakti dhe Euralius që në rast se në njërin nga tre kategoritë e meritave kandidati nuk merr 60% të pikëve (p.sh në mundësinë që kandidati merr 0 pikë në meritat morale për mungesë integriteti ose reputacioni ndonëse është shumë i kualifikuar profesionalisht, në mundësinë që gjithë kandidatët e paraqitur kanë nivel shumë të ulët profesional etj.), KED ti bëjë me dije organit të emërtesës që të mbajë parasysh se, ndonëse është lejuar kandidimi dhe në total kandidati ka marrë pikë për të qenë në tri vendet e parë, ai është i papërshtatshëm për tu zgjedhur.

Grzegorz Borkovski (*përkthen përkthyesja*), mbi kërkesën dhe pyetjet e anëtarëve të Këshillit për shpjegime, kërkon fjalën dhe parashtron se sikurse u paraqit në relativitetin nuk do të gjeni në asnjë vend në ligj të përmendur rastin e 60% të pikëve për kriter. Por ne menduam që kjo është një mënyrë e duhur që Këshilli të mund të shprehte se matematikisht ky kandidat është i kualifikuar por me të ka një moment, siç përmendet edhe ju, në fushën në integritet, ku ai mund të mos ketë marrë asnjë pikë. Gjithashtu kjo është një mënyrë vlerësimi dhe vendimmarrja i takon Presidentit dhe është Presidenti është ai që duhet të dijë se kandidati ka marrë pikë por ka një problem në lidhje me të. Ne po flasim për situatë hipotetike dhe natyrisht edhe ndodh. Pra ju thoni kush do të jetë reagimi publik për një person për të cilin Këshilli thotë që është i papërshtatshëm megjithatë ai zgjidhet në detyrë. Nëse e themi ndryshe, kemi një kandidat i cili ka bërë publikime, por nga ekspertët na thuhet se ai ka bërë plagjiaturë, por megjithatë ai ka numrin e mjaftueshëm të pikëve për tu votuar si kandidat, a do ti mbyllni sytë apo do ti thonit organit të emërtesës që ka diçka që nuk shkon me këtë. Pra, mund të zgjidhni mënyrën tjetër për të mos thënë këtë gjë, por kjo nuk është mënyra më e mirë për të zgjedhur kandidatët më të mirë si gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, sepse përndryshe ju do të përfundoni si mbledhës matematike, sic thotë Dvorani, mund të ketë profesorë që kanë sjellje të parregullta me studentet që ndodh kudo në botë. Ju do të mbyllni sytë? Kjo ishte ideja pas këtij propozimi.

Bledar Dervishaj, gjatë diskutimit mes anëtarëve për pikën 66 dhe veçanërisht lidhur me mundësinë e shprehjes së papërshtatshmërisë së kandidatit për tu zgjedhur nëse ka më pak se 60% të pikëve për secilën nga kategoritë e meritave, kërkon fjalën dhe parashtron se pa përsëritur asnjë gjë, nga ato që thanë anëtarët e Këshillit dhe EURALIUS, qëllimi duket që është i mirë. Situata hipotetike që mund të ndodhin në shoqërinë shqiptare ka të pafundme. Nisur nga numri i kandidatëve që të paktën kanë ardhur nga vakancat me kohëzgjatje të madhe mund të them që nuk do të ndeshemi me këtë situatë. KED-ja ka të qartë kompetencat e veta, duhet të bëjë vlerësim, renditje, pikëzim, dorëzim listash. Problemi është në momentin që ka marrë një vendim lejimi kandidimi dhe na del në kriterin moral një problem. Lind pyeja a mund të revokojë, shfuqizojë KED vendimin e saj të lejimit të kandidimit? Në këtë pozicion ligji nuk i ka lënë shumë hapësirë KED-së për të qënë krijues në këtë nivel. Kriteri i 60% nuk është pranueshëm. Nuk gjej kurrësi vend që ta vendosësh e ta mbeshtetësh diku në ligj apo Kushtetute. Kjo ka të bëjë direkt me skualifikimin. Në një moment që ti po bën pikëzimin, tu shfaq një falsifikim. Është ndoshta momenti që KED të marrë vendim për revokimin e kandidimit dhe për kallëzim ndaj kandidatit. Për të mos neglizhuar mundësitë përjashtimore, mund të rritet pesha specifike e secili kriter të moralit dhe hetimi që kryhet nga relatori të rritet më shumë.

Në rastin hipotetik që diskutuat më parë, nëse të tre kandidatët e listës janë të papërshtatshëm, atëherë ju po transferoni problemin tek ne. Ju nuk po e zgjidhni çështjen. Atëherë ne nuk po shprehemi fare dhe ai me më pak problematiku të zgjidhet. Ne do të bëjmë një letërkëmbim dhe do ti themi KED-së pse e sollët kur nuk i donit. Më këtë propozim duket sikur KED po plotëson një vakum që ka ligji. Është evidente. I vetmi mekanizëm që mund ta zgjidhë këtë problem është Kuvendi, duke e ndryshuar ligjin me 3/5 e votave dhe duke e përfshirë edhe këtë pikë. Në po na erdhi ky shqetësim nuk kemi mekanizëm zgjidhës.

Unë kam shqetësimin si organ emërtesës për të pasur kandidatura të pastra. Por ka ca detaje që Këshilli përderisa po mblidhet, po përdor edhe dhomë keshillimi ku diskutohet gjithçka atëhere ky detaj do të zgjidhet nga Këshilli. Në këtë projekt rregullore është parashikuar që paralelisht nis puna dhe për verifikimin e ndalimit ose lejimin, edhe për vlerësim-pikëzimin. Aty do të dalë fakti që ju mund merrni edhe vendim për ndalimin e kandidimit.

Nuk mendoj që do të shfaqet ky problem edhe për një arsye tjetër. Ngaqë të tre organet kanë më shumë se një vakancë dhe do të ndahen në listë gjyqtarësh dhe listë juristësh, nuk besoj që në gjyqësor ka nivele të tilla që të kandidojnë dhe nuk do arrijnë një minum. Nuk jemi në ato nivele ekstreme ku askush nuk ka aplikuar për të qenë gjyqtar. Në vakanca kemi 24 kandidatë, tek tjetra 23 etj.. Pra, kemi kandidat. Dhe aq sa jemi njohur në njoftimet publike nuk është se janë në nivele të tilla

Medi Bici, kërkon fjalën dhe informon Këshillin se duke qenë se në këto diskutime e ka të vështirë të marrë pjesë pa qenë vetë në konflikt te paster interesi, deklaroj nga ky moment që heq dorë nga kandidatura ime për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, edhe meqënesë jemi vetëm dy kandidatë. Të hapet procesi për të pasur sa më shumë gjyqtar, dukë marrë shëmbull edhe nga rasti i Inspektorit të Lartë i Drejtësisë ku nga 3 kandidatë minimumi që ishte tani arriti në 13. Kështu që unë do të jem aktiv dhe të merrem me problemet e Këshillit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pasi merr mendimin e anëtarëve për rendin e ditës dhe kohën e mbledhjes së ardhshme, duke u përcaktuar zhvillimi i saj në datën 28 Mars, në orën 17.00, me rend dite: *Diskutimi dhe miratimi i Projektvendimit për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*, deklaroi mbylljen e mbledhjes.

MBLEDHJA MBYLLET NË ORËN 20.00

Sekretare
Dorina Dulaj
Ermelinda Kadiu

Kryetari
Ardian Dvorani

Redjona Myrtja

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga personel i vetë institucioneve të ftuar.